

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE DURRËS
Nr. 1557 rep. 652³ kol.



KONTRATË SHITJE

(kuote kapitali themeltar)

Sot, në datë **18.11.2019** (tetëmbëdhjetë Nëntor dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje noterit Emil P. Barçi, me seli në qytetin e Elbasanit, lagja "Kongreai i Elbasanit", rruga "28 Nëntori", pall. 36, kt.1, u paraqitën palët kontraktuese, e kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje për pasuri të luajtshme, sipas kushteve të mëposhtme :

- Në cilësinë e shitësit : **GJERGJI KRISTO**, atësia Andrea, i dtl. 14.07.1979, lindur dhe banues në Elbasan, me NID - **H90714009S**, pajisur me letërnjoftim nr. 028820630, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Në cilësinë e blerësit : **MUHARREM MURGA**, atësia Shaban, i dtl. 20.03.1948, lindur në Peshk, Mat, banues në Paskuqan, Tirana, pajisur me letërnjoftim nr. 030117106, me NID – **E80320073K**, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Objekt i kësaj kontrate është shitja tërësisht e kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë "BIO FLORES" sh.p.k. nga ortaku i vetëm Gjergji Kristo, në favor të blerësit Muharrem Murga.
- Shoqëri tregtar "BIO FLORES" sh.p.k. është regjistruar në Q.K.B. në datë 09.09.2019, pajisur me NIPT – L93309203B, me seli në fshatin Kusarth, njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, me ortak të vetëm z. Gjergji Kristo, që zoteron 100 % të kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë. Sipas ekstraktit të Q.K.B.-së, marrë elektronikisht në datë 18.11.2019, shoqëria rezulton me status "aktiv".
- Lidhja e kontratës bëhet në referim të nenit 705 e vijues të Kodit Civil, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare", dhe vendimit nr. 1, datë 18.11.2019, të Ortakut të vetëm të shoqërisë tregtar, ku është vendosur shitja tërësisht e kuotës së kapitalit themeltar, në favor blerësit.
- Sipas konfirmimit të marrë elektronikisht në datë 18.11.2019, nga Regjistri i Barrëve Siguruese, nuk ka të regjistruar asnjë akt ligjor në ngarkim të shoqërisë "Bio Flores" sh.p.k. dhe të ortakut të vetëm Gjergji Andon Kristo.
- Palët kontraktuese deklarojnë se kanë caktuar si çmim shitje për **100 %** e kuotës së kapitalit themeltar, vlerën monetare **100.000 Lekë** (njëqindmijë), e cila është transferuar nga blerësi, tek shitësi, tërësisht në Cash, dhe jashtë kësaj zyre noterie.

Two handwritten signatures are present at the bottom left. The first signature, on the left, appears to be "Gjergji Kristo". The second signature, on the right, appears to be "Muhammed Murga".

- Shitësi deklaron se garanton se deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga ana e tij, janë shlyer të gjitha detyrimet tatimore, lidhur me tatim fitimin, akcizën, tatimin mbi të ardhurat personale, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, e taksat vendore si dhe nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për transferimin e pronësisë së kuotës së kapitalit themeltar të kësaj shoqërie tregtare. Shitësi deklaron se merr përsipër çdo detyrim ligjor si dhe shlyerjen e çdo financiar, që mund të konstatohet në të ardhmen, për periudhën deri në nënshkrimit të kësaj kontrate.
- Palët kontraktuese do të përgjigjen në mënyrë solidare për çdo detyrim që rrjedh nga zotërimi i kuotës së kapitalit të shoqërisë, nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate deri në çastin e regjistrimit të saj.
- Me nënshkrimi i kësaj kontrate shitje nga palët kontraktuese, pronësia e kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë "BIO FLORES" sh.p.k. do të rezultojë tërësisht në pronësi të z. Muhammed Murga.
- Blerësi, në bazë të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", duhet të kryejë regjistrimin e kontratës pranë Q.K.B.-së.

Kontrata u redaktua në tre kopje të njëjta, të cilat pasi u lexuan nga palët kontraktuese, me vullnet të të lirë e të plotë, u nënshkruan para noterit. Bashkangjitur kontratës është një kopje e vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

Shitës

GJERGJI KRISTO

Blerës

MUHARREM MURGA

Noter

EMIL P. BARÇI

